

VENDIM
Nr. 834, datë 3.12.2014

PËR KONVERTIMIN E SIPËRFAQES PREJ 29.8 HA, NGA KATEGORIA E RESURSIT “TOKË BUJQËSORE” NË KATEGORINË E RESURSIT “TOKË URBANE”, PËR T’U PËRDORUR NGA BASHKIA FUSHË-KRUJË SI ZONË ME PRIORITET ZHVILLIMI EKONOMIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11/1, të ligjit nr.8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Konvertimin e sipërfaqes prej 29.8 ha, nga kategoria e resursit “tokë bujqësore” në kategorinë e resursit “tokë urbane”, për t’u përdorur nga Bashkia Fushë- Krujë si zonë me prioritet zhvillimi ekonomik, sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, Qarku Durrës, të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral përkatës ndryshimin e kategorisë së resursit nga “tokë bujqësore” në “tokë urbane” (truell) për sipërfaqen 29.8 ha, sipas pikës 1, të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Qarkut Durrës, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës dhe Bashkia Fushë-Krujë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

PASYRË TABELARE E TOKËS/FASHOS QË KËRKOHET TË KONVERTOHET, BAZUAR TEK IPV-JA BASHKIA FUSHË KRUJË:

Njësia Strukturore	Zona Kadastrale (Z.K.)	Fshati	Numri Pasurisë	Sipërfaqja (Ha)	Nga Kjo:			Sipërfaqja faktike e zene me ndertime dhe mbushje me inerte (%)
					Arë (ha)	Pemetore (ha)	Vreshte (ha)	
10	1934	Hasan	8	4.5	4.5	0	0	50
			21					
8	1934	Hasan	26	9.8	9.8	0	0	50
			3					
			5					
			6					
			28					
			321					
7	1042	Arrameras	322	12.5	12.5	0	0	85
			323					
			324					
			325					
			326					
			327					
			328					
			329					
			12					
			13					
			17					
			18					
			34					
			35					
			45					
			46					
			47					
			48					
			63					
			65					
			72					
			76					
17	2385	Larushk	60	2.5	2.5	0	0	85
			77					
			130					
			140					
			141					
			146					
			154					
			61					
			356					
			282/34					
14/12	1665	Arrameras		0.5	0.5	0	0	70
TOTAL QË KËRKOHEN TË KONVERTOHEN				29.8				

